



Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit  
Municipality of Hani Elezit

Në bazë të nenit 12.2 e 51 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 23.2, 39.6, 40, 41.3 dhe 30, 31, 35, 36 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit Kuvendi Komunal në me datën 25.11.2010 miraton, këtë :

**RREGULLORE  
PËR  
PUNËN E KOMITETEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet përbërja, kompetencat, aktivitetet, mënyra e punës dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare në komitetet e Kuvendit të Komunës konform dispozitave të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitat e Statutit të Komunës.

**Neni 2  
Përkufizimet**

2.1 Në këtë rregullore përkufizime „ Ligj „ nënkupton Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 të dt. 20. shkurt 2008.

2.2 Përkufizimi „Statut“ nënkupton Statutin e Komunës.

2.3 Përkufizimi „ Kuvendi i Komunës „ , nënkupton organin më të lartë të Komunës.

2.4 Përkufizimi „ Komitet „ , nënkupton komitetet e formuara nga Kuvendi i Komunës.

2.5 Përkufizimi „ Shërbimi Profesional për Punët e Kuvendit „ , nënkupton shërbimin përkatës që ofron shërbime profesionale, juridike dhe teknike për komitetet e Kuvendit të Komunës.

**II. PËRBËRJA, KOMPETENCAT DHE AKTIVITETET E KOMITETEVE**

**Neni 3  
Nocioni i Komiteteve**

3.1 Komitetet janë trupa ndihmës të Kuvendit të Komunës dhe punojnë për dhe në emër të Kuvendit të Komunës. Roli i tyre është që të lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve pasi që Kuvendi nuk është në gjendje që në mënyrë adekuate të merret me numrin e jashtëzakonshëm të problemeve dhe çështjeve të ndryshme.



3.2 Shumë probleme me të cilat ballafaqohet komuna janë të një natyrë teknike e që kërkojnë angazhimin e ekspertëve që nuk janë anëtar të Kuvendit, por që shërbejnë si anëtarë të komiteteve relevante. Prandaj, komitetet janë të destinuara që ta lirojnë Kuvendin nga humbjet joproduktive të kohës dhe përpjekjeve, duke i ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit ekspertiza politike, juridike, financiare, teknike, konsultime dhe angazhim në çështje specifike.

3.3 Themelimi i komiteteve funksionale i përgjigjet nevojave të Komunës së Hanit të Elezit të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa do të mbajë mbledhje për çdo muaj, ndërsa komitetet tjera do të mbajnë mbledhjet punuese sipas nevojës.

3.4 Shumica e anëtarëve të komiteteve, (pos komiteteve konsultative) do të jenë anëtar të Kuvendit të Komunës .Anëtarësia e anëtarëve në komitete do të reflektohet sa më shumë që është e mundur me proporcionin e vendeve që kanë partitë politike në Kuvendin e Komunës.

#### Neni 4

#### Kompetencat e përgjithshme dhe rolet e komiteteve

4.1 Komitetet mund të propozojnë prioritet e buxhetit brenda një fushe të caktuar në mënyrë që të drejtohen në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe të aprovohen nga Kuvendi i Komunës.

4.2 Komitetet do të bëjnë analiza të rregullta të aktiviteteve të drejtorive përkatëse (planet e punës, raportet mujore dhe vjetore, raportet mbi vlerësimin etj.) dhe formimin e propozimeve për Kryetarin e Komunës, në përmirësimin e kryerjes së punëve nga drejtoritë.

4.3 Komitetet do të sigurojnë përgatitjen dhe hartimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës që i referohen një fushe të caktuar të aktiviteteve brenda përgjegjësisve të komitetit.

4.4 Të gjithë anëtarët e komiteteve konform dispozitave të Statutit të Komunës, do të marrin kompensim financiar për pjesëmarrje në punën e komiteteve komunale. Kryesuesi i komitetit do të jetë përgjegjës për koordinimin e punës së komitetit komunal, si dhe të përgatisë orarin e mbledhjeve ad-hoc, të udhëheq listën e pjesëmarrësve, të sigurojë procedurat e kompensimit të anëtarëve të komitetit, informatat mbi vlerësimin individual të kryerjes së punëve nga anëtarët dhe të paraqesë raport për punët e komitetit.

4.5 Komitetet mund të formojnë nën komisione dhe grupe punuese për detyrat të caktuara brenda mandatit të tij.

4.6 Administrata komunale do të ofrojë mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për rregullimin e punëve të komiteteve duke përfshirë shpërndarjen e materialeve për mbledhje sipas nevojës, vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen në dosje procesverbalet dhe materialet e tjera të komiteteve.

#### Neni 5

#### Formimi i komiteteve

5.1 Konform dispozitave të nenit 35.1. të Statutit të Komunës, në Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit formohen dy komitete të përhershme:

- Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe



- Komiteti për Komunitete.

5.2 Koform dispozitive të nenit 36.2 të Statutit të Komunës, në Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit formohen këto komitete konsultative me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes siç janë.

- a) Komiteti për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale
- b) Komiteti për Zhvillim Ekonomik, planifikim Urban dhe M. të Ambientit
- c) Komiteti për Shërbime Publike dhe Emergjencë

**Komitetet e përhershme**  
**Neni 6**  
**Komiteti për Politikë e Financa**

6.1 Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej 5 ( pesë ) anëtarëve.

6.2 Kompetencat e Komitetit për Politik dhe Financa janë:

- Të identifikojë dhe të formulojë programet zhvillimore strategjike të Komunës;
- Të përcaktoj dhe zhvilloj format dhe mënyrat e organizimit të hyrave në buxhet;
- Të zhvilloj procedurat për investime dhe të shpenzimeve të buxhetit sipas vlerësimeve;
- Të shqyrtoj nevojat e mëdha ekonomike dhe sociale të Komunës, si dhe çështjet me rëndësi të veçanta;
- Të mbështet zhvillimin ekonomik brenda Komunës duke përfshirë privatizimin;
- Të këshillojë Kuvendin në mënyrë të përgjithshme në lidhje me procedurat financiare dhe ekonomike;
- Është përgjegjës për shqyrtimin e kornizës vjetore buxhetore dhe afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloreve komunale, e sidomos rregulloreve për tatimin, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe marrjen e raporteve nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës;
- Të mbikëqyrë aktivitetet e administratës komunale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me publikun dhe ndërlihdjen me shtypin;
- Të mbështesë partneritetin në mes të qytetarëve;
- Të ushtojë të gjitha funksionet e Kuvendit të Komunës në raste emergjente të cilat përcaktohen nga Kryetari dhe Kuvendi i Komunës;
- Të merret me funksionet autorizuese dhe detyrat e Kuvendit të Komunës;
- Për çdo vit fiskal i rekomandon Kuvendit të Komunës, numrin e stafit civil që do të emërohet apo mbetet në secilin drejtori, së bashku me titujt dhe gradat e tyre;
- Të këshillojë dhe konsultohet me Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorinë për Administratë dhe Personel.

**Neni 7**  
**Komiteti për Komunitete**

7.1 Konform dispozitive të nenit 35.2 të Statutit të Komunës, Komiteti për Komunitete përbëhet prej 5 anëtarëve.



7.2 Në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitat e Statutit të Komunës, Komiteti për Komunitete do të përpiqet që brenda territorit të komunës të sigurojë se:

- Asnjë person që kryen detyra zyrtare apo punon në zyrë publike nuk do të diskriminojë ndonjë person tjetër në çfarëdo baze siç është gjuha, religjioni, origjina etnike, apo asocimit me ndonjë komunitet;
- Të gjithë personat i gëzojnë në masë të njëjtë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe një punësim i drejtë, dhe i barabartë duhet të shërbejë në komunë në të gjitha nivelet;
- Shërbimi civil komunal reflekton një proporcion të drejtë të përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet;
- Komiteti për Komunitete do të sigurojë të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve që jetojnë brenda komunës, dhe gjithashtu të sigurojë se një shoqëri ku shumë llojshmëria e traditave kulturore, sociale dhe religjioze është jo vetëm e toleruar por edhe e inkurajuar;
- Komiteti për Komunitete i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me nevojën e komiteteve për ta mbajtur, shprehur dhe avancuar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtjen adekuate të drejtave të komuniteteve brenda Komunës;
- Komiteti do t'i mbikëqyrë aktivitetet e Zyrës për Komunitete, të formulojë propozime për Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunës për përmirësimin e punëve të Zyrës.

#### **Komitetet Konsultative**

#### **Neni 8**

#### **Komiteti për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale**

8.1 Komiteti për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale përbëhet prej 5 pesë anëtarëve, që duhet të reflektoj në kuotën gjinore.

8.2 Kompetencat e këtij komiteti, janë:

- Të shqyrtojë rregullat për arsim;
- Të këshilloj dhe konsultohet me Drejtorinë e Arsimit;
- Të përgatisë rregullore, udhëzime dhe vendime për ti dorëzuar Kuvendit të Komunës në miratim;
- Të dëgjoj apelet nga nxënësit në lidhje me kualitetin e mësimin dhe masave disiplinore;
- Të propozoj dhe mbështesë raportin shkollë-shoqëri në mes të shkollave dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private, të cilat merren me arsimimin e personave;
- Të parashikoj dhe vlerësoj nevojat arsimore të komunës në të ardhmen;
- Të përcaktojë prioritetet globale për qytetin në sferat e Kulturës, Sportit dhe Rinisë;
- Të hartojë një program të investimeve kapitale në mënyrë që t,u ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme;
- Të ofrojë një pasqyrë buxhetore dhe të bëjë rekomandimet e nevojshme;
- Të këshillojë dhe konsultohet me Drejtorinë për Kulturë, Rini e Sport;



- Ti kushtoj vëmendje të veçantë nevojave të lagjeve periferike dhe rajoneve rurale;

- Të mbështesë kremtimin e festave të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare;  
- Të paraqesë dhe rekomandojë për diskutim buxhetore ngjarjet e rregullta dhe të rëndësishme , festivalët e kampionatët;

- T, i kushtojë kujdes të veçantë ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit.

Në punën e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sipas nevojës personat në vijim do të marrin pjesë:

- Përfaqësuesi ndërkombëtarë;  
- Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit, Kadastrit e Pronës dhe Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

- Drejtori i Qendrës së Punës Sociale;

- Shoqatat Bamirëse;

- UNHCR - i;

- Drejtori i Shtëpisë së Shëndetit.

Kompetencat e këtij komiteti janë:

- Të monitorojë implementimin e shërbimeve për kujdesin primar shëndetësor në Komunë;

- Komiteti përfaqësohet në Bordin e Shtëpisë së Shëndetit;

- Shqyrton projekt - buxhetin për shëndetësi dhe jep propozime për Komitetin për Politikë dhe Financa;

- Shqyrton planin vjetor të punës të përgatitur nga Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

- Monitoron zbatimin e dispozitave në lidhje me grupet e varfra të njerëzve, invalidëve të luftës, viktimave e dhunës familjare, fëmijë të mitur, të pastrehëve, të rikthyerve dhe pensionistëve;

- Të këshillojë dhe konsultohet me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

- Të ndihmojë në caktimin e fondeve për strehim, në pajtim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

- Formulimi i propozimeve për strategjitë strehuese duke përfshirë ndërtimin e shtëpive me qira, dhe prioritetet kryesore përkatëse për renovime ndërtimesh dhe ndihmën financiare;

- Zbatimi i standardeve për përmirësimin e përshtatshmërisë dhe riparimin e strehimoreve private;

- Shqyrtimi i hollësishëm i propozimeve për planet strehuese;

- Propozon Komitetit për Politikë dhe Financa shumën e qirasë për shfrytëzuesit e pronës komunale për çështje të strehimit;

#### Neni 9

### Komiteti për Zhvillim Ekonomik, planifikim Urban dhe M. të Ambientit

9.1 Komiteti përbëhet prej 5 anëtarëve, prej të cilëve duhet të reflektohet gjithashtu kuota gjinore..

9.2 Kompetencat e këtij komiteti janë:



- Të këshillojë dhe konsultohet me Drejtorinë e Financave Ekonomisë dhe Zhvillimit;
- Inicimi i programeve dhe projekteve zhvillimore komunale;
- Përcjelljen e aktiviteteve të subjekteve ekonomik të biznesit dhe dhënia e këshillave dhe udhëzimeve të nevojshme profesionale;
- Marrja pjesë në Projekt hartimin e planit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës;
- Përgatitjen e planeve konkrete për zhvillimin e industrisë zejtare;
- Përgatitja e planeve konkrete për zhvillimin e bujqësisë;
- Kontribuon në krijimin e kushteve të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
- Të këshillojë dhe konsultohet me Drejtorinë e Planifikimit Urbanizmit; Kadastrit dhe Pronës dhe Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes e Ambientit;
- Të përcjell zhvillimin e planit rregullues;
- Shqyrtimi i çështjes në lidhje me transportin publik dhe propozimet strategjike për magjistralet;
- Shqyrtimi i nevojës, dizajnit dhe lokacionit për të gjitha zhvillimet e reja;
- Të përcjell çdo çështje që ka të bëjë me ndërtimin;
- Të kontrollojë procedurat për vendosjen e qosheve;
- Të kontrollojë procedurat për reklamimet;
- Të kontrollojë procedurat për zbatimin e planifikimit, vërejtjet për ndalim dhe urdhrat për rrënim;
- Të ushtroj mbrojtjen dhe kontrollin e ndërtesave me interes arkitektonik apo historik;
- Të ndihmojë dhe të ruan ambientin;
- Parandalimi i ndotjes ambientale të ajrit, tokës dhe ujit;
- Përcjell mirëmbajtjen e parqeve, fushave rekreative dhe të argëtimit, shëtitoreve publike, hapësirave të hapura publike të Komunës;
- Të mbështes zhvillimin e ardhshëm të Komunës, posaçërisht në lidhje me vijë-veprimin e tokës;
- Përbrenda vijë-veprimeve të vendosura dhe vlerësimeve të aprovuara të Kuvendit, t'i rekomandohet Kuvendit përvetësimin apo dhënien nëpërmes blerjes; shitjes, lëshimit me qira, licencimit apo dhurimit të tokës apo objektit ose në interesat e të drejtat në lidhje me tokën.

#### **Neni 10**

#### **Komiteti për Shërbime Publike dhe Emergjencë**

10.1 Komiteti për Shërbime Publike dhe Emergjencë përbëhet prej 5 anëtarëve, së paku preferohet të jetë një anëtar nga radha e KFOR-it si dhe një nga PK-ja .

10.2 Kompetencat e këtij komiteti janë, si vijon:

- Të këshillohet dhe konsultohet me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës dhe Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
- Të shqyrtojë planin e punëve të drejtorive;
- Diskuton, ndryshon dhe aprovon projekt rregulloret e Komunës të përgatitura nga drejtori i drejtorisë dhe i dorëzon Komitetit për Politikë dhe Financa në shqyrtim dhe miratim përfundimtar;



- Përmes bordeve të ndërmarrjeve komunale: themelon vijë veprime, përshtatë nivelet e shërbimeve dhe stafit, monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave për afrimin e shërbimeve, cakton burimet në përputhje me rrethanat;
- Të propozojë masat adekuate dhe të angazhojë institucionet përkatëse për ndihmë popullsisë së rrezikuar me qëllim të zbutjes së dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare (tërmetet, vërshimet, zjarri);
- Të marrë masa adekuate për angazhimin e potencialit njerëzor dhe mjeteve materiale në zvogëlimin dhe eliminimin sa më të mundshëm të pasojave të shkaktuara nga këto fatkeqësi duke vepruar konkretisht në vendin e ngjarjes;
- Të propozojë masa konkrete për funksionimin e qendrës për koordinim, informim dhe alarmim;
- Të ushtroj kontrollin e ndërmarrjeve me interes të veçantë për Komunën në pajisjen dhe mënyrën e mbrojtjes kundër zjarrit;
- Të koordinoj punët me njësitin e zjarrfikësit për reagim sa më të shpejtë në rast të paraqitjes së nevojës;
- Të koordinoj punët me SPK-në, FSK-në, Eulexin, KFOR-in, QKMF, Kryqin e Kuq Komunal për një organizim më efikas në zbutjen e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme.

### **Neni 11 Komitetet konsultative**

11.1 Komitetet konsultative janë komitete profesionale të cilat themelohen në kuptim të nenit 73 të LVL -e.

11.2 Komitetet konsultative themelohen nga Kuvendi i Komunës, pas propozimit të marrë nga Kryetari i Komunës, nga komitetet e përhershme dhe nga grupi i qytetarëve.

11.3 Anëtarësimi në komitete konsultative bëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare, të cilat duhen të jenë njohës dhe profesionistë të mirë të lëmive përkatëse.

11.4 Mënyra e zgjedhjes dhe themelimit të këtyre komiteteve bëhet sipas konkursit publik, në të cilin përcaktohen kriteret dhe kushtet e konkurrimit, kandidatët për anëtarë të komiteteve duhet të jenë banorë të Komunës së Hanit të Elezit.

11.5 Kuvendi i Komunës ngritë Kolegjium për intervistimin e kandidatëve, i cili në përbërje duhet të ketë anëtarë të Kuvendit dhe të Shoqërisë Civile.

11.6 Kolegjiumi i propozon Kuvendit të Komunës listën e kandidatëve për komitete konsultative.

## **III. INAGURIMI DHE PUNA E KOMITETEVE TË KUVENDIT**

### **Neni 12 Mbledhjet inauguroese të komiteteve**

12.1 Komiteti për Politik dhe Financa e mbanë mbledhjen inauguroese, në afat prej 15 ditësh nga mbledhja inauguroese e Kuvendit të Komunës, pas certifikimit të rezultateve zgjedhore nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.



**12.2** Komiteti për Komunitete dhe Komitetet e tjera të themeluara nga Kuvendi i Komunës, i mbajnë mbledhjet inauguruese në afat prej 30 ditësh, nga dita e zgjedhjes së anëtarëve të komiteteve me vendim të Kuvendit të Komunës.

**12.3** Mbledhjet inauguruese të komiteteve thirren nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, nëse ai është zgjedhur.

**12.4** Nëse mbledhjet inauguruese të komiteteve nuk i thërret Kryesuesi i Kuvendit, brenda afatit të paraparë me dispozitat e nenit 14.1 dhe 14.2 të kësaj Rregulloreje, atëherë anëtari më i vjetër i zgjedhur i komitetit, fiton të drejtën që brenda afatit prej 15 ditësh të thërras mbledhjen e komitetit.

**12.5** Nëse anëtari më i vjetër i komitetit nuk e thërret mbledhjen sipas obligimit të tij në nenin paraprak, mbledhja inauguruese e komitetit mund të caktohet me iniciativën e shumicës së anëtarëve të zgjedhur të komitetit.

### **Neni 13**

#### **Mbledhja e komiteteve, thirrja, numri i tyre dhe njoftimi i mbajtjes**

**13.1** Kryesuesit i komiteteve duhet të thërras dhe kryesojnë mbledhjet e komiteteve përkatëse.

**13.2** Në mungesë të kryesuesit, ose kur ai nuk është në gjendje të punojë, mbledhja do të thirret dhe kryesohet nga anëtari më i vjetër i pranishëm.

**13.3** Komiteti për Politikë dhe Financa mban së paku 1 ( një ) mbledhje në muaj në vitin kalendarik, ndërsa Komiteti për Komunitete dhe Komitetet tjera mbajnë mbledhjet sipas nevojës.

**13.4** Orari i mbledhjes së rregullt të komitetit - ve, me propozimin e kryesuesit të komiteteve, duhet të miratohet në mbledhjen inauguruese të tij.

**13.5** Të gjithë anëtarët e komitetit njoftohen paraprakisht me shkrim, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

Njoftimi duhet të Përmbajë:

- a) Datën e mbajtjes së mbledhjes,
- b) Kohën e mbajtjes së mbledhjes,
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes,
- d) Rendin e mbajtjes së mbledhjes,
- e) Materialet e mbledhjes, dhe
- f) Të dhënat tjera që mund të përcaktohen me Statut ose më këtë Rregullore.

**13.6** Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe Rregulloren komunale për gjuhët në përdorim zyrtar në komunë.

**13.7** Njoftimi duhet të shpallet publikut, në tabelën e shpalljes, web-faqen e komunës apo në mediat e shkruara elektronike lokale, përmes zyrës komunale për informim.

**13.8** Njoftimi sipas nevojë i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, në Prishtinë.



## Neni 14 Mbledhjet e jashtëzakonshme të komiteteve

14.1 Kryesuesi i komitetit mund të konvokojë në çdo kohë kur paraqitet nevoja mbledhjet e jashtëzakonshme të komitetit .

14.2 Numri i anëtarëve i cili njëherit përbën kuorumin e komiteteve në çdo kohë, kur paraqitet nevoja mund të thërret mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme.

14.3 E drejta për të thirr një mbledhje të jashtëzakonshme , gjithashtu përfshinë të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar .

14.4 Pikët e caktuara në rendin e ditës për mbledhjen e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

14.5 Mbledhja e jashtëzakonshme nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e komitetit dhe publiku nuk është njoftuar me shkrim, së paku 3 ditë pune par datës së mbajtjes së mbledhjes.

14.6 Mënyra e debatit dhe votimit në mbledhjet e jashtëzakonshme të komiteteve do të bëhet konform rregullave të mbledhjes së rregullt, përveç rasteve kur mbledhjet e jashtëzakonshme thirren për shkak të rrethanave urgjente.

## Neni 15 Kuorumi dhe mënyra e votimit

15.1 Kuorumi për mbledhjen e komiteteve - tit përbëhet prej më tepër se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të komiteteve, kuorumi duhet të verifikohet para çdo fillimi të mbledhjes dhe gjatë marrjes së vendimit konkret.

15.2 Në mbledhjet e komiteteve - tit secili anëtarë e ka të drejtën e një vote. Kryesuesi i komitetit kur e udhëheqë mbledhjen e komitetit ( në mungesë të kryesuesit ), kanë një votë shtesë në rast të numrit të votave të njëjta për apo kundër një propozimi.

15.3 Vendimet ( që kanë të bëjnë me çështjet e funksioneve autorizuese dhe detyrat e Kuvendit të Komunës ), rekomandimet, konkluzionet, propozimet dhe aktet tjera të komiteteve si rregull miratohen me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje që votojnë.

15.4 Gjatë marrjes së vendimeve, votimi bëhet me aklamacion -ngritje të dorës, përveç në rastet kur komiteti vendosë që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë.

Anëtarë i komitetit ka të drejtë që me ngritjen e dorës të votoj „ për „ „ kundër „ apo të „abstenoj „ nga votimi.

15.5 Para votimit, secili anëtarë i komitetit ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen ashtu që të shihen emrat e të gjithë anëtarëve që kanë votuar edhe emrat e atyre që abstenojnë.

15.6 Secili anëtar i komitetit mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes të shënohet se si ai apo ajo ka votuar për çështjen e caktuar apo nëse ka abstenuar nga votimi.

15.7 Kur komiteti vendos që për një çështje të votohet me vota të fshehta, Shërbimi Profesional për Punët e Kuvendit, do të kujdeset që të organizohet një votim i tillë dhe atë duke siguruar fletëvotimet e nevojshme, kutin e votimit, renditjen e kandidatëve në listë, numërimin publik të fletëvotimeve para anëtarëve të komiteteve.

15.8 Shërbimi Profesional për Punët e Kuvendit, së paku 12 muaj, duhet t,i ruajë fletëvotimet dhe materialin tjetër zgjedhor në vend të sigurt.



## Neni 16

### Procedimi në mbledhjet e komiteteve rendi i ditës

16.1 Rendi i ditës për mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa caktohet nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës, ndërsa rendin e ditës për Komitetin për Komunitete dhe Komitetet Funkzionale caktohet nga kryesuesi i komiteteve -tit.

16.2 Me rastin e caktimit të rendit të ditës për Komitetin për Komunitete dhe Komitetet Funkzionale, kryesuesi i komitetit konsultohet paraprakisht me kryetarin e Komunës, kryesuesin e Kuvendit të Komunës dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse.

16.3 Anëtari i komitetit mund të kërkojë shtimin e një pike të rendit të ditës gjatë mbledhjes së rregullt të komitetit, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend dite është çështje urgjente me rëndësi publike. Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.

16.4 Rendin e ditës për çdo mbledhje të komitetit, me material përkatës të nevojshëm e përgatitë Shërbimi Profesional për Punët e Kuvendit.

16.5 Në mbledhje mund të vendoset që të punohet edhe me rend të ditës të ndryshuar.

16.6 Rendi i ditës pas shqyrtimit dhe vënies për miratim, miratohet me votë të hapët - ngritje dore me shumicë votash të anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.

16.7 Pas miratimit të rendit të ditës, në mbledhje mund të propozohet ndryshimi apo plotësimi i rendit të ditës, i cili propozim qitet në votim nga kryesuesi dhe mund të vendoset me vota të hapëta-ngritje dore, me shumicë votash të anëtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.

## Neni 17

### Shpërndarja e materialit shtesë për mbledhje

17.1 Çdo anëtar i komitetit në afatin e paraparë nga neni 15.6 i kësaj Rregulloreje , bashkë me ftesën për mbledhje i dërgohet dhe materiali sipas pikave të rendit të ditës.

17.2 Nëse prej ditës së dërgimit të materialit e deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes, sipas nevojës urgjente është paraqitur raport apo propozim, atëherë Shërbimi Profesional për Punët e Kuvendit, në mbledhje anëtarëve ua shpërndanë materialin përkatës.

## Neni 18

### Rregullat e shqyrtimit dhe diskutimit

18.1 Pas miratimit të rendit të ditës dhe shkoqitjes ( referimit ) të pikës përkatëse të rendit të ditës, kryesuesi i mbledhjes e hap diskutimin.

18.2 Kur kryesuesi e udhëheq dhe diskuton në mbledhje, anëtarët e tjerë duhet të qëndrojnë ulur dhe dëgjojnë debatin pa ndërhyrje deri në përfundim.

18.3 Pas hapjes së diskutimit, secili anëtar i komitetit mund të kërkojë fjalën për diskutim nga kryesuesi.

18.4 Kryesuesi në mbledhje nuk do të lejojë asnjë propozim deri sa të gjithë që dëshirojnë të diskutojnë të kenë bërë këtë për kohë të mjaftueshme .



## Neni 19 Kohëzgjatja e diskutimit dhe replikimit

19.1 Secili anëtarë i komitetit gëzon të drejtën në diskutim të barabartë lidhur me çështjet që debatohen në rendin e ditës, pa u zgjeruar jashtë pikës për të cilën debatohet, duke qenë aktiv në mbledhje.

19.2 Po ashtu, secili anëtar ka të drejtë diskutim për çdo pikë të rendit të ditës më së shumti dy herë nga 5 minuta, me të drejtë replikimi një herë vetëm 2 minuta.

19.3 Nëse zgjatët diskutimi apo replikimi i anëtarit të komitetit, kryesuesi së pari ia tërheqë vërejtjen e nëse nuk ka sukses, atëherë ai ndërpret diskutimin.

19.4 Gjatë diskutimit apo replikimit të një anëtari, anëtarët e tjerë të komitetit nuk kanë të drejtë ndërhyrje dhe ndërprerje, ata duhet të dëgjojnë duke qëndruar ulur.

19.5 Kur për diskutim paraqiten dy ose më shumë anëtarë në të njëjtën kohë kryesuesi vendos radhën për diskutim të secilit diskutues, duke paralajmëruar paraprakisht secilin diskutues që vijë me radhë.

19.6 Në çdo kohë dhe për çdo diskutim mbi pikat e rendit të ditës, vendimi i kryesuesit duhet të jetë i pranishëm dhe përfundimtarë, qoftë për një propozim që nuk mund të diskutohet apo kur një propozim i ndryshuar veç ka zëvendësuar propozimin e parë.

19.7 Kur propozimi është duke u diskutuar, nuk lejohet propozime tjera përveç në raste kur propozimi është i arsyeshëm, dhe:

- Kërkon ndryshime të atij propozimi;
- Nëse propozimi i rinj ka të bëjë më parandalimin e shkeljeve procedurale;
- Propozimet për të kaluar në pikën e radhës së rendit të ditës;
- Propozimet për të përjashtuar publikun dhe shtypin;
- Propozimi për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar në mbledhjen e ardhshme;
- Propozimi i cili kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit;
- Propozimi për ndërprerjen e mbledhje.

19.8 Për të mbyllur pikën e rendit të ditës dhe për të kaluar në pikë tjetër apo mbylljen e diskutimit dhe marrjen e vendimit për një çështje, apo për të shtyrë diskutimin për mbledhjen e ardhshme ose për të ndërprerë mbledhjen kryesuesi do të vendosë pasi që të gjithë anëtarët e komitetit t'i kenë dhënë fjalimet e tyre për kohë të mjaftueshme.

## Neni 20 Procesverbali

20.1 Në të gjitha mbledhjet e komiteteve – tit, mbahet procesverbal.

20.2. Procesverbali mbahet në pajtim me dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, Statutin e Komunës dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

20.3 Procesverbali nga mbledhja e kaluar, miratohet në mbledhjen e radhës së komitetit.

20.4 Procesverbali përmban të gjitha të gjitha të dhënat valide të mbledhjes, emrat e anëtarëve të pranishëm dhe atyre të ftuar, pastaj emrat e pjesëmarrësve të tjerë, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit, rekomandimet, konkluzionet, propozimet dhe aktet tjera të miratuara apo të refuzuara.



20.5 Në procesverbal duhet të shënohet mënyra e votimit, rezultati i votimit, numri i votave „ për „ dhe „ kundër „ , si dhe abstenimet, ndërkaq që procesverbali mund të shikohet nga anëtarët e komitetit, për rezultatet e votimit.

20.6 Nëse kërkohet të thirret emri i anëtarit, në procesverbal shënohet si ka votuar secili.

#### Neni 21

##### Sjelljet jo të mira dhe masat që mund të ti ndërmerr kryesuesi

21.1 Nëse kryesuesi i mbledhjes konstaton se ndonjëri prej anëtarëve të komitetit, nuk sillet mirë në mbledhje duke mos respektuar urdhrat e kryesuesit, pengon punën e mbledhjes, duke mos u sjellë mirë, kryesuesi ia tërheqë vërejtjen.

21.2 Nëse sjelljet e anëtarit vazhdojnë të jenë të pandryshueshme, kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmerr një të njënjë prej këtyre masave:

- U propozon të pranishmëve në mbledhje që anëtari të mos dëgjohet, dhe nëse një propozim i tillë aprovohet, anëtarit i ndalohet fjalimi i mëtutjeshëm në mbledhje;
- Propozon që anëtari të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes për veç në raste kur do të ketë votime;
- E shtynë mbledhjen për një orë deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë.

#### Neni 22

##### Pjesëmarrja e publikut në mbledhje

22.1 Pjesëmarrja e publikut në mbledhjet e komiteteve më së afërmi do të përcaktohet me Rregulloren e veçantë komunale për Konsultim të publikut në vendimmarrje.

22.2 Kur pjesëtari i publikut me dashje ndërpre punimet e mbledhjes, kryesuesi i mbledhjes do të ia tërheq vërejtjen atij.

22.3 Kur pjesëtari vazhdon të ndërpresë mbledhjen, kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmerr një të njënjë prej këtyre masave:

- a) E udhëzon pjesëtarin të tërhiqet nga mbledhja;
- b) Jep urdhrin që pjesëtari të largohet nga mbledhja;
- c) E shtyn mbledhjen për një orë ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë.

22.4 Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim më të madh, kryesuesi i mbledhjes mund të urdhëroj që të gjithë të lirojnë sallën e mbledhjes dhe mund të shtyjnë mbledhjen për një orë ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili do të caktohet më vonë.

#### Neni 23

##### Ndërprerja dhe shtyrja e mbledhjeve

23.1 Mbledhja e caktuar e komiteteve –tit shtyhet kur paraqiten shkaqet të cilat e pamundësojnë mbajtjen e saj në ditën e caktuar.

23.2 Mbledhja e komitetit shtyhet edhe kur pas hapjes konstatohet se në mbledhje nuk marrin pjesë numri i mjaftueshëm i anëtarëve të komitetit për vendosje meritore.

23.3 Për shtyrjen e mbledhjes së komiteteve vendos kryesuesi i komitetit.

23.4 Mbledhja e komitetit ndërpritet në rastet si vijon:

- a) Me qëllim të pushimit gjatë mbledhjes;



b) Kur gjatë mbledhjes numri i anëtarëve të komiteteve bie nën numrin e paraparë për mbajtjen e mbledhjes dhe vendosjes meritore;

c) Kur për shkak të qëndrimit të gjatë në mbledhje, e njëjta nuk mund të kryhet atë ditë, dhe

ç) Kur vjen deri te prishja e rëndë e rendit të ditës, dhe kryesuesi nuk është në gjendje që mbledhjen ta kthejë në gjendje normale pune.

23.5 Seanca e ndërprerë vazhdon me të njëjtën rend pune të nesërmen nëse nuk është ditë pushimi.

#### IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

##### Neni 24

##### Kolizioni i dispozitave

24.1 Në rast të kolizionit të dispozitave të kësaj Rregulloreje me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale apo Statutin e Komunës, Rregulloren mbi Punën e Kuvendit, drejtpërdrejt do të vlejë dispozitat e Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Statutin, Rregullores mbi Punën e Kuvendit.

##### Neni 25

##### Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të kësaj Rregulloreje, do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes dhe miratimit të saj.

##### Neni 26

##### Interpretimi autentik

Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e bënë Kuvendi i Komunës.

##### Neni 27

##### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj.

Data: 25.11.2010  
Nr.01/174/2010

